

VENDIM
Nr. 1104, datë 28.12.2015

PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMIT TË MBETJEVE, TË KRIJUARA NGA ANIJET DHE TEPRICAT NGA NGARKESAT, NË DET¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 40, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin, vendosjen dhe miratimin e kërkesave për parandalimin e shkarkimit të mbetjeve, të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat e tyre, në det, me synim mbrojtjen e mjedisit detar nga anijet, gjatë përdorimit të porteve të Republikës së Shqipërisë.

2. Rregullat e përcaktuara në këtë vendim do të zbatohen për:

a) të gjitha anijet, përfshirë mjetet e peshkimit dhe mjetet lundruese për argëtim, pavarësisht nga flamuri, shenja e thirrjes apo veprimtaria e tyre brenda një porti shqiptar;

b) të gjitha portet e Shqipërisë që ankorohen nga anijet e përcaktuara në shkronjën “a”, më sipër.

3. Drejtoria e Përgjithshme Detare siguron që anijet e përfshira në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij vendimi, të dorëzojnë mbetjet e krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat e tyre, në mënyrë të vazhdueshme, tek operatorët e licencuar për grumbullimin dhe trajtimin e tyre, referuar legjislacionit në fuqi.

4. Përkufizimet e nenit 3, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003, “Për autoritetin portual”, ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009, “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë”, dhe ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a) “Certifikata e dorëzimit të mbetjeve”, formulari (që jepet në aneksin IV, të këtij vendimi) i plotësuar, që vërteton se anija ia ka dorëzuar mbetjet operatorit të instalimeve marrëse, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

b) “Marpol 73/78”, Konventa Ndërkombëtare për parandalimin e ndotjes nga anijet, 1973, të ndryshuar nga Protokoli i 1978 në lidhje me të, i miratuar me ligjin nr. 9594, datë 27.7.2006, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare për Parandalimin e Ndotjeve nga anijet, 1973, të ndryshuar me Protokollin e vitit 1973”.

c) “Mjet lundrues për argëtim”, mjet lundrues i çdo lloji, pavarësisht mënyrës së forcës shtytëse, që përdoret për qëllime sportive ose jo.

ç) “(Mjet) Anije peshkimi”, çdo anije e pajisur me mjete përkatëse ose që përdoret për kapjen e gjallesave ujore.

d) “IMO”, Organizata Ndërkombëtare Detare.

dh) “Operator”, në kuptim të këtij vendimi, çdo person fizik ose juridik, mbajtës i lejeve dhe licencave, referuar legjislacionit në fuqi, për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve në portet dhe radat e tyre.

e) “Tepricat nga ngarkesat”, tepricat nga ngarkesat detare, përfshirë mbetjet e çdo lloji të ngarkesës në bord, nga mbajtëset e ngarkesave ose cisternat, të cilat teprojnë pas përfundimit të procedurave të shkarkimit dhe pastrimit.

ë) “Tarifë ekologjike e mbetjeve”, pagesa e detyrueshme që kryen çdo anije dhe mjet lundrues që prek portet e hapura dhe radat e tyre, për mbulimin e kostove të instalimeve marrëse portuale

¹Ky vendim përaftron plotësisht Direktivën 2000/59/EC “Mbi instalimet marrëse portuale për mbetjet e krijuara nga anija dhe teprica nga ngarkesat” ndryshuar nga Direktiva 2002/84/EC, Rregullorja (EC) 2007/71/EC dhe Rregullorja (EC) 1137/2008. Numri CELEX 32000L0059, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr.332, datë 28.12.2000, faqe 81.

për mbetjet e krijuara nga anijet, përfshirë trajtimin dhe asgjësimin e tyre nga operatorët e licencuar, të kontraktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, që ofrojnë shërbimin e tërheqjes së mbetjeve, referuar aneksit VI, bashkëngjitur.

5. Drejtoria e Përgjithshme Detare sigurohet që kapacitetet e instalimeve marrëse portuale, të instaluar nga operatorët e licencuar, të jenë të mjaftueshme dhe të plotësojnë nevojat e anijeve, pa i shkaktuar atyre vonesa të pajustificuara. Për këtë gjë, kapiteneritë e porteve ngarkohen për verifikimin e kapaciteteve të instalimeve portuale marrëse dhe, në rastet e verifikimit të mosefikasitetit të tyre, detyrohen të njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme Detare për marrjen e masave.

6. Drejtoria e Përgjithshme Detare ngarkohet për transportin, në përputhje me kërkesat e IMO-s, duke përcaktuar, me urdhër, procedurat e raportimit në Kapitenerinë e Portit, në rastet kur pretendohet për efikasitet të pamjaftueshëm të instalimeve marrëse portuale.

7. Operatorët e licencuar, të kontraktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, duhet të zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të tërhequr sasinë dhe llojet e mbetjeve, të krijuara nga anijet që përdorin atë port normalisht, dhe tepricat nga ngarkesat e tyre, duke marrë parasysh nevojat funksionale të përdoruesve të portit, madhësinë dhe pozicionin gjeografik të portit, llojin e anijeve që japin shenjë të thirrjes në atë port, si dhe të garantojnë trajtimin e këtyre mbetjeve në impiantet e tyre, të certifikuar dhe licencuar sipas legjislacionit mjedisor në fuqi dhe standardeve e normave të lejuara evropiane.

8. Drejtoria e Përgjithshme Detare, në konsultim me palët e interesuara, veçanërisht me përdoruesit e porteve, harton dhe zbaton, për çdo port, një plan të përshtatshëm për marrjen dhe trajtimin e mbetjeve, duke kontraktuar operatorë të licencuar, që plotësojnë standardet, referuar kërkesave të pikave 5 deri 24, të këtij vendimi. Kërkesat specifike për hartimin e këtyre planeve përcaktohen në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi.

9. Plan, referuar në pikën 8, më sipër, hartohet në nivel rajonal ose kombëtar, me përfshirjen e çdo porti, duke siguruar që nevojat për instalimet marrëse dhe disponibiliteti i tyre të specifikohen individualisht, për çdo port, dhe miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për transportin.

10. Ministria përgjegjëse për transportin vlerëson dhe monitoron më tej zbatimin e planit, referuar në pikat 8 e 9. Plan rishikohet dhe miratohet, të paktën, çdo tre vjet, si dhe pas ndryshimeve të rëndësishme në funksionimin e portit, apo në rastet kur operatorët e licencuar prezantojnë një projekt të ri, sipas standardeve më të fundit të teknologjisë, i cili garanton menaxhimin më të mirë të mundshëm të mbetjeve portuale të anijeve dhe mjeteve lundruese.

11. Kapiteni i anijes, që detyrohet të ankorohet në një port në Shqipëri, duhet të plotësojë, me anë të vetdeklarimit, me vërtetësi dhe saktësi, formularin e paraqitur në aneksin II, dhe t'ia njoftojë Kapitenerisë së Portit, nëpërmjet agjencive detare,;

a) të paktën 24 orë para mbërritjes, në qoftë se porti i thirrjes është i njohur;

b) sapo të njihet porti i thirrjes, në qoftë se informacioni i kërkuar sigurohet në më pak se 24 orë përpara mbërritjes;

c) pak kohë pas largimit nga porti i mëparshëm, në qoftë se kohëzgjatja e udhëtimit është më pak se 24 orë.

12. Kapiteneria e Portit i dërgon një kopje të njoftimit, të përcaktuar në pikën 11, të këtij vendimi, Autoritetit Portual dhe operatorit të instalimeve marrëse portuale. Operatori është i detyruar të mbajë një regjistër për njoftimet dhe certifikatat e dorëzimit të mbetjeve dhe t'ia përcjellë ato, çdo muaj, Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

13. Kapiteni i anijes ruan kopje të informacionit, të përcaktuar në pikën 11, të këtij vendimi, për një periudhë dyvjeçare, në bordin e anijes, dhe, me kërkesën e tyre, ua vë në dispozicion Drejtorisë së Përgjithshme Detare ose organeve të tjera, të caktuara për këtë qëllim nga ministria përgjegjëse për transportin dhe ministria përgjegjëse për mjedisin.

14. Kapiteni i anijes që ankorohet në një port shqiptar, përpara largimit nga porti, i dorëzon të gjitha mbetjet e krijuara nga anija, sipas aneksit IV, të këtij vendimi.

15. Anija nuk është e detyruar të dorëzojë çdo ditë mbetjet e krijuara, por mund të vazhdojë

për në portin tjetër të thirrjes pa i dorëzuar ato, në qoftë se, sipas informacionit të dhënë, në përputhje me aneksin II, ka kapacitet magazinimi të mjaftueshëm për të gjitha mbetjet e krijuara dhe ato të mundshme të krijohen gjatë udhëtimit të planifikuar të anijes deri në portin e dorëzimit.

16. Drejtoria e Përgjithshme Detare, kur ka arsye të mjaftueshme për të besuar se porti i planifikuar për dorëzimin e mbetjeve nuk disponon instalimet e duhura ose në qoftë se ky port është i panjohur dhe, si pasojë, ka rrezik që mbetjet të shkarkohen në det, merr të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar ndotjen detare dhe/ose i kërkon anijes të dorëzojë mbetjet e saj përpara largimit nga porti.

17. Ministria përgjegjëse për transportin, pas konsultimeve me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, sigurojnë që kostot e instalimeve marrëse portuale për mbetjet e krijuara nga anijet, përfshirë trajtimin dhe largimin e tyre, të mbulohen përmes mbledhjes së tarifës ekologjike, të detyruar për anijet dhe mjetet lundruese për mbetjet.

18. Ministri përgjegjës për transportin dhe ministri përgjegjës për financat, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, bazuar në modelet e ngjashme të porteve të rajonit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 84, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, miratojnë, me udhëzim të përbashkët, vlerën e tarifës ekologjike të detyruar për anijet dhe mjetet lundruese, me qëllim marrjen e shërbimit, referuar në pikën 17, më sipër. Përlllogaritja e përcaktimit të vlerës së kësaj tarife ekologjike bëhet bazuar në tonazhin përkatës të çdo mjeti lundrues, referuar parimit “Ndotësi paguan”.

19. Tarifën ekologjike të marrjes dhe përpunimit të mbetjeve e paguajnë të gjitha anijet dhe mjetet e lundrimit që ankorohen në portet e hapura dhe radat e tyre, pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe, më pas, kjo e fundit likuidon, për çdo rast shërbimi, operatorin e instalimeve marrëse portuale, referuar kontratës përkatëse.

20. Tarifa ekologjike dhe sistemi i mbulimit të kostos, për përdorimin e instalimeve marrëse portuale, duhet të mos stimulojnë anijet dhe mjetet lundruese që të shkarkojnë mbetjet e tyre në det.

21. Tarifa ekologjike për anijet e peshkimit, anijet e shërbimit detar (rimorkiator, pilotina dhe bargat e ndryshme, që përdoren për punime në port), si dhe mjetet që përdoren për argëtim (jahtet, skafet sprotive, mjetet e vogla për gjueti amatore si dhe mjetet e vogla detare me më pak se 12 pasagjerë) do të jetë e ndryshme nga ajo e përcaktuar në pikën 20, të këtij vendimi. Ajo do t'i nënshtrohet një regjimi tjetër, për vet llojin e aktivitetit që ato ushtrojnë, sipas modelit më të përshtatshëm që do të propozohet nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, dhe do të miratohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin dhe ministrit përgjegjës për financat.

22. Kapiteni i anijes që akomodohet në portet e hapura dhe radat e tyre në Republikën e Shqipërisë duhet të sigurojë që tepricat nga ngarkesat të dorëzohen në një instalim marrës portual, në përputhje me dispozitat Marpol 73/78. Përdoruesi i instalimeve marrëse paguan tarifën për dorëzimin e tepricave nga ngarkesat.

23. Kontrolli Shtetëror Portual/Kapiteneria e Portit duhet të sigurojë që çdo anije të jetë objekt inspektimi për verifikimin e përputhshmërisë së saj me rregullat e përcaktuara në pikat 14, 15, 16 e 24, të këtij vendimi.

24. Kontrolli Shtetëror Portual/Kapiteneria e Portit, kur inspekton anijet e autorizuara për të mbajtur jo më shumë se 12 pasagjerë, përveç mjeteve të peshkimit dhe mjeteve lundruese për argëtim, gjatë inspektimit:

a) vepron në kuadër të ligjit nr. 9852, datë 26.12.2007, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Memorandumin e Mirëkuptimit, “Për Kontrollin Shtetëror Portual”;

b) në qoftë se nuk bindet nga rezultatet e këtij inspektimi, duhet të sigurojë që anija të mos largohet nga porti pa dorëzuar, sipas pikave 14, 15 e 16, të këtij vendimi, mbetjet e krijuara dhe tepricat nga ngarkesat e saj në instalimin marrës portual;

c) informon autoritetin kompetent të portit tjetër të thirrjes, kur ka të dhëna të sigurta se anija

ka dalë në det pa plotësuar rregullat e përcaktuara në pikat 14, 15 e 16, të këtij vendimi. Ky i fundit, përveç sa parashikohet në pikën 30, të këtij vendimi, nuk duhet ta lejojë anijen të largohet nga ai port derisa të kryejë një vlerësim më të detajuar të zbatimit të këtij vendimi, veçanërisht të saktësisë së çdo informacioni të dhënë, sipas pikave 11, 12 e 13, të këtij vendimi.

25. Drejtoria e Përgjithshme Detare përcakton procedurat e kontrollit që sigurojnë plotësimin e kërkesave të këtij vendimi nga mjetet e peshkimit dhe mjeteve lundruese për argëtim, të autorizuar të mbajnë jo më shumë se 12 pasagjerë, anijet e shërbimit detar, rimorkiatorët, pilotazhet, bargat etj.

26. Ministria përgjegjëse për transportin duhet të:

a) marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që kapitenët e anijeve, operatorët e instalimeve marrëse portuale dhe personat e tjerë të interesuar të informohen në mënyrën e duhur dhe të plotësojnë detyrimet që u burojnë nga ky vendim;

b) bashkëpunojë me autoritetet përkatëse ndërkombëtare, përfshirë IMO-n, dhe çdo ent tjetër tregtar, për të siguruar zbatimin efektiv të këtij vendimi;

c) sigurojë që informacioni i njoftuar nga kapitenët e anijeve, në përputhje me pikat 11, 12 e 13, të këtij vendimi, të shqyrtohet në mënyrën e duhur;

ç) sigurojë që formalitetet, në lidhje me përdorimin e instalimeve marrëse portuale, të jenë të thjeshta e të shpejta dhe nxitin kapitenët e anijeve të përdorin instalimet marrëse portuale e të shmangin vonesat e pajustificuara të anijeve;

d) sigurojë që trajtimi, nxjerja ose largimi i mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat e tyre të kryhen vetëm nga operatorë të licencuar dhe të miratuar nga Ministria e Mjedisit, me lejet dhe licencat përkatëse, referuar legjislacionit në fuqi.

dh) informojë të gjitha palët e përfshira në dorëzimin ose marrjen e mbetjeve të krijuara nga anijet ose tepricat nga ngarkesat e tyre, për efekt kompensimi për dëmin e shkaktuar nga vonesa të pajustificuara, në përputhje me Kodin Civil dhe Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë.

27. Anija që ka dorëzuar mbetjet e krijuara prej saj mund të largohet nga porti.

28. Ministria përgjegjëse për transportin bashkëpunon me autoritetet përkatëse ndërkombëtare, përfshirë IMO-n, për ngritjen e një sistemi të përshtatshëm informacioni, identifikimi të anijeve dhe monitorimi, që:

a) lehtëson identifikimin e anijeve që nuk kanë dorëzuar mbetjet e krijuara dhe tepricat nga ngarkesat e tyre, sipas këtij vendimi;

b) lejon të vlerësohet nëse është arritur qëllimi i përcaktuar në pikën 27, të këtij vendimi.

29. Ministria përgjegjëse për transportin bashkëpunon me autoritetet përkatëse ndërkombëtare, përfshirë IMO-n, për përcaktimin e kriterëve të përbashkëta për identifikimin e anijeve.

30. Shkeljet e dispozitave të këtij vendimi, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen sipas pikës 38, të nenit 62, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar.

31. Drejtoria e Përgjithshme Detare paraqet çdo vit, në ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe në ministrinë përgjegjëse për transportin, raportin për zbatimin e këtij vendimi.

32. Ministria përgjegjëse për mjedisin dhe ministria përgjegjëse për transportin bashkëpunojnë me Drejtorinë e Përgjithshme Detare për të siguruar përputhshmëri me parashikimet në fuqi të IMO-s, në qoftë se është i nevojshëm përmirësimi i regjimit të përcaktuar nga ky vendim, por pa zgjeruar objektin e këtij vendimi, referencat në instrumentet IMO dhe anekset e këtij vendimi.

33. Ngarkohen ministria përgjegjëse për transportin, ministria përgjegjëse për mjedisin dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

KËRKESAT PËR PLANIN E MARRJES DHE TRAJTIMIT TË MBETJEVE NË PORT

Plani i marrjes dhe trajtimit të mbetjeve në port duhet të mbulojë të gjitha llojet e mbetjeve të krijuara dhe tepricat nga ngarkesat në det që vijnë nga anijet që vizitojnë portin normalisht. Ai duhet të hartohet në përputhje me madhësinë e portit dhe llojet e anijeve që japin shenjë e thirrjes në atë port.

Plani duhet të përfshijë elementet e mëposhtme:

a) vlerësimin e nevojës për instalime marrëse portuale nisur nga nevojat e anijeve që vizitojnë portin normalisht;

b) përshkrimin e llojit dhe kapacitetit të instalimeve marrëse portuale;

c) përshkrimin e hollësishëm të procedurave për marrjen dhe mbledhjen e mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat;

d) përshkrimin e sistemit të pagesës;

- Detaje të tarifës së propozuar sipas modeleve të ngjashme të rajonit dhe BE-së;

- Metodatat e llogaritjes.

e) procedurat për raportimin mbi mangësitë e pretenduara të instalimeve marrëse portuale;

f) procedurat për konsultimet e vazhdueshme me përdoruesit e portit, kontraktuesit e mbetjeve, operatorët e terminalit dhe palët e tjera të interesuara;

g) llojet dhe sasitë e mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat të marra dhe të trajtuara;

h) Një përmbledhje të legjislacionit përkatës dhe të formaliteteve për dorëzimin e mbetjeve dhe tepricave;

i) Identifikimin e personit ose personave përgjegjës për zbatimin e planit;

j) Një përshkrim të pajisjeve dhe proceseve paratrajtuese në port, nëse ka ose jashtë tij;

k) Një përshkrim të metodave që janë përdorur për raportimin e përdorimit aktual të instalimeve marrëse portuale;

l) Një përshkrim të metodave që janë përdorur për raportimin e të dhënave mbi sasinë e mbetjeve dhe tepricat e ngarkesave të dorëzuara nga anijet;

m) Një përshkrim të mënyrës së largimit të mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat.

Procedurat për marrjen, mbledhjen, magazinimin, trajtimin dhe largimin e mbetjeve dhe tepricave nga ngarkesat e anijeve duhet të jenë në përputhje me sistemet e menaxhimit të mjedisit sipas standardeve me të fundit evropiane dhe të miratuara, gjithashtu, nga ministria përgjegjëse për mjedisin.

Informacioni që i vihet në dispozicion të gjithë përdoruesve të portit:

- Një referencë e shkurtër mbi rëndësinë e dorëzimit të mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat në përputhje me kërkesat e këtij vendimi;

- Vendndodhja e instalimeve marrëse portuale të aplikueshme në çdo vend ankorimi me diagram /hartë;

- Lista e mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat që trajton normalisht;

- Lista e pikave të kontaktit, operatorët e licencuar dhe shërbimet e ofruara;

- Procedura e dorëzimit;

- Sistemi i pagesës; dhe

- Procedurat për raportimin e mangësive të pretenduara për instalimet marrëse portuale.

ANEKSI II

INFORMACIONI QË ANIJA DUHET TË NJOFTOJË PËRPARA HYRJES NË PORTET SHQIPTARE

1. Emri, shenja e thirrjes dhe sipas rastit, numri IMO i identifikimit të anijes:
2. Flamuri i shtetit:
3. Koha e vlerësuar e mbërritjes (ETA):
4. Koha e vlerësuar e nisjes (ETD):
5. Porti i mëparshëm i thirrjes:
6. Porti tjetër i thirrjes:
7. Porti i fundit dhe data kur janë dorëzuar mbetjet e krijuara nga anija:
8. Në instalimin marrës portual do të dorëzoni (shëno kutinë e duhur):
☐ Të gjitha ☐ disa ☐ asnjë nga mbetjet tuaja?
9. Llojin dhe sasinë e mbetjeve dhe tepricave që do të dorëzohen dhe/ose mbahen në bord dhe përqindjen që ato zënë në raport me kapacitetin maksimal të magazinimit:
Në qoftë se dorëzoni të gjitha mbetjet plotësoni kolonën e dytë.
Në qoftë se dorëzoni disa ose nuk dorëzoni mbetje, plotësoni të gjitha kolonat.

Lloji	Mbetjet që do të dorëzohen (në m ³)	Kapaciteti maksimal i magazinimit (në m ³)	Sasinë e mbetjeve që do të mbahen në bord (në m ³)	Porti ku do të dorëzohen mbetjet e mbajtura	Sasia e vlerësuar e mbetjeve që do të gjenerohet nga moment i njoftimit deri në mbërritjen në portin tjetër të thirrjes (në m ³)
Vajra të përdorur					
Llumra					
Ujë i sentinave					
Të tjera (specifikoni)					
Mbetje të ngurta					
Mbetje nga ushqimet					
Mbetje plastike					
Mbetje të tjera					
Ujëra të ndotura (1)					
Mbetje që shoqërojnë ngarkesat (2) (specifikoni)					
Tepriat nga ngarkesat (2) (përcaktoni)					

1. Ujërat e ndotura mund të shkarkohen në det në përputhje me Rregulloren 11 të aneksit IV të Marpol 73/78. Në rast të një shkarkimi të autorizuar në det kutitë përkatëse nuk plotësohen.

2. Mund të jenë vlerësime.

ANEKSI III

KRITERET MINIMALE PËR PËRCAKTIMIN VLERËS SE TARIFËS EKOLOGJIKE PËR MBETJET

Tarifa për shërbimet dhe përdorimin e instalimeve marrëse portuale do të hartohen në bazë të kriterëve minimale të përcaktuara në këtë aneks sipas pikave A dhe B.

A. Tarifa ekologjike e mbetjeve llogaritet duke shumëzuar tarifën për njësi, që propozohet nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, me faktorin e përcaktuar në pikën B, më poshtë.

B. Përlllogaritja e tarifës ekologjike të mbetjeve do të bëhet sipas formulës çmim për njësi (që do të propozohet nga Drejtoria e Përgjithshme Detare) $\times$ GRT e anijes përkatëse. Me anën e aplikimit të kësaj formule bazuar në modelin europian, nuk është e nevojshme që të bëhet klasifikimi sipas llojit të anijes (ngarkesa të Përgjithshme, cisterna, anije pasagjeresh etj.) dhe tarifimi vjen në progresion aritmetik në lidhje me tonazhin e anijes dhe gjenerimin e të gjitha llojeve të mbetjeve

ANEKSI IV
VËRTETIMI PËR DORËZIMIN E MBETJEVE DHE MBETURINAVE TË ANIJES

1. Emri i anijes dhe numri i IMO, IMO number/ _____
Name, IMO identification number of ship:
2. Flamuri i shtetit/Flag country: _____
3. Vendi i shkarkimit/Place of discharge. _____
4. Agjenti /Agent: _____
5. Data e mbërritjes/Date of arrival: _____
6. Data e nisjes/Date of departure: _____
7. Koha e shkarkimit/Time of discharge: _____
8. Tipi dhe sasia e mbetjeve të dorëzuara/Type and quantity of waste delivered (bej shënime në kutinë përkatëse/ tick appropriate box):

Tipi i mbetjeve <i>Type of waste</i>	Sasia e mbetjeve të raportuara në / <i>Amount to waste report ed in the order</i> m ³	Sasia e mbetjeve të tërhequra/ <i>Amount of waste received</i> m ³
1. Mbetje nga karburati (Waste oils)		
1.1 Llumra (<i>Sludge</i>)		
1.2 Ujë sentinash (<i>Bilge water</i>)		
1.3 Slope (<i>Slops</i>)		
1.4 Të tjera (<i>Others</i>)		
1.4. Pece me karburant (<i>Oily rags</i>)		
2. Mbeturina (Garbage)		
2.1 Mbeturina ushqimesh (<i>Food waste</i>) Bej shënime në se keni mbledhur mbeturinat dhe do ti dorëzoni më vete veç (<i>Mark only if you have collected and will discharge separately</i>)		
2.2 Mbeturina të riciklueshme mbeturina të paketuara (Recyclable waste, packaging waste) Bej shënime në se keni mbledhur mbeturinat dhe do ti dorëzoni më vete (<i>Mark only if you have collected and will discharge separately</i>)		
2.2.1 Plastik (<i>Plastic</i>)		
2.2.2 Letër (<i>Paper</i>)		
2.2.3 Xham (<i>Glass</i>)		
2.2.4 Metale (<i>Tin</i>)		
2.3 Mbeturina sanitare të përziera (<i>Mixed domestic Waste</i>)		
2.4 Të tjera specifiko (<i>Other, specify</i>)		
2.4.1 Mbetje të rrezikshme/ Hazardous waste (Të përshtatshme, specifiko)		
3. Mbeturina që dalin nga ngarkesa <i>Cargo associated waste</i> (Të përshtatshme, specifiko)		
4. Mbetje të ngarkesës (<i>Cargo residues</i>)		
5. Ujëra të ndotura (<i>Sewage</i>)		
DORËZUAR NGA / TËRHEQUR NGA / <i>DELIVERED Emri Firma dhe</i> <i>RECEIVED BY Emri Firma (Name, signature)</i> Vula e anijes (<i>Name, signature,</i>		Shënime/NOTES

vessel's stamp)		
-----------------	--	--

ANEKSI V
FORMATI I NJOFTIMIT PËR MBETJET TË GRUMBULLUARA NGA ANIJET
NOTIFICATION FORM FOR SHIP-GENERATED WASTE

Sipas ligjit nr. 9594, datë 27.7.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për parandalimin e ndotjeve nga anijet, 1973 të ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (marpol73/78)"

Për: KAPITANERINË E PORTIT TË ____

To **HARBOUR MASTER OFFICE**

1. DETAJE TË ANIJES

SHIP DATUM

1.1 EMRI I ANIJES Ship's name	1.5 SHENJA NDËRKOMBËTARE E THIRRJES Call sign
1.2 NUMRI I I.M.O. I.M.O. Number	1.6 SHTETI I FLAMURIT Flag State
1.3 PRONARI OSE CHARTERUESI Owner or the Charterer	
1.4. Tipi i anijes 1.4 Tipo di nave ☐ naftëmbajtëse ☐ kimikatesh ☐ transport rifuxho ☐ konteiner <i>Oil Tankers Chemical carrier Bulk carrier Container</i> ☐ anije të tjera ngarkese ☐ anije pasagjere ☐ Ro-Ro ☐ Të tjera (specifikojë) <i>Others cargo ship passengers ship Ro-Ro Others (specify)</i>	

2. DETAJE TË PORTIT TË FUNDIT DHE UDHETIMIT

Last port and voyage datum

2.1 Data dhe ora e parashikuar e mbërritjes Date and E.T.A.	2.6 Porti i fundit i prekjes në të cilin janë dorëzuar mbeturinat e grumbulluara në anije Last port of call and date when liquid waste was delivered
2.2 Data dhe ora e parashikuar e nisjes Date and E.T.D	2.7 Data e fundit e dorëzimit të mbeturinave Last port of call and date where solid waste was delivered
2.4. Porti i fundit i prekjes dhe shteti Last previous port of call and State	2.8 Emri i Kapitenit të anijes që njofton këtë model Name of the Master ship that notifies this model
2.5 Porti i ardhshëm i prekjes Next port of call	2.9 Emri i agjencisë The name of the agenci

Mendoni të dorëzoni mbeturinat në impiantet portuale të mbledhjes? ☐ TË GJITHA ☐ DISA ☐ ASGJË
Are you delivering all, some, none of your waste into port reception facilities? ALL SOME NONE

TIPI DHE SASIA E MBETJEVE PËR TË DORËZUAR DHE/OSE DO TË MBAHEN NË BORDIN E ANIJES DHE PËRQINDJA E DEPOZITIMIT MAKSIMAL
TIPE AND AMMOUNT OF WASTE AND RESIDUES TO BE DELIVERED AND/OR REMAINING ON BOARD, AND PERCENTAGE OF MAXIMUM STORAGE

Në rastet kur mendoni të shkarkoni të gjitha mbeturinat që janë në bord, plotësoni vetëm kolonën e dytë (Mbeturinat që dorëzohen në m³), në rast se mendoni të dorëzoni disa ose asgjë plotësoni të gjitha kolonat (Mbeturinat që dorëzohen në m³)
If delivering all waste, complete second column as appropriate - If delivering some or no waste, complete all columns

	Mbeturinat	Kapaciteti	Sasia e	Porti në të	Sasia e llogaritur
--	------------	------------	---------	-------------	--------------------

TIPI <i>TYPE</i>	për dorëzim m ³ <i>Waste to be delivered</i> m ³	max i depozitimit m ³ <i>Maximum dedicated storage capacity</i> m ³	mbeturinave që mbahen në bord m ³ <i>Amount of waste retained on board</i> m ³	cilin do të dorëzohen mbeturinat e mbetura në bord <i>Port at which remaining waste will be delivered</i>	mbeturinave që do të generohen që nga njoftimi e deri në portin e ardhshëm të prekjës në m ³ <i>Estimated amount of waste to be generated between notification and next port of call</i> m ³
MARPOL – Aneksi 1 OLI – oil					
Ujë sentinash <i>Oily Bilge water</i>					
Mbetje vajore - Slaxhe – <i>Oily residues (Sludge)</i>					
Ujë vajor pas larjes së cisternave <i>Oily tank washings</i>					
Ujë i ndotur i ballasteve <i>Dirty ballast water</i>					
Mbeturina dhe slaxhe pas larjes së cisternave <i>Scales and sludge from tank cleaning</i>					
Të tjera (specifiko) <i>Others (please specify)</i>					
Mbetje nga ngarkesa (specifiko) <i>Cargo residues (specify)</i>					
MARPOL Aneksi II – Materiale helmuese të lëngshme – (m³) /emri <i>Marpol Annex II – Noxious Liquid Substances – (m³) /name</i>					
Materiale të kategorisë X <i>Kategoria e ndotjes X Materiali</i>					
Materiale të kategorisë Y <i>Kategoria e ndotjes Y Materiali</i>					
Materiale të tjera <i>Other substances (OS)</i>					
Mbetje nga ngarkesa (specifiko) <i>Cargo residues (specify)</i>					
MARPOL Aneksi IV – Ujë i zbrazur <i>MARPOL Annex IV – Sewage</i>					
Ujë i zbrazur <i>Sewage</i>					
MARPOL Aneksi V – Plehra <i>MARPOL Annex V – Garbage</i>					
Mbeturina ushqimore <i>Food waste</i>					
Plastike <i>Plastic</i>					
Mbeturina të ngarkesës (pajisje të ambalazhimit dhe mbulimit të ngarkesës etj.) <i>Cargo associated waste (Floating dunnage, lining, packing materials, etc)</i>					
Prodhime të letrës, lecka, xhama, pece, metalike, shishe etj.)					
Mbeturina të djegieve <i>Incinerator ash</i>					
Plehra të tjera (specifiko) <i>Others refuse types</i>					
Mbetje nga ngarkesa (specifiko) <i>Cargo residues (specify)</i>					

(1) Ujërat e zbrazjes mund të shkarkohen në det në përputhje me rregullat 11 të aneksit IV të protokollit Marpol 73/78. Kutitë korresponduese nuk plotësohen nëse mendoni që të bëni një shkarkim të autorizuar në det.
Sewage may be discharged at sea in accordance with Regulation 11 of Annex IV Marpol 73/78. The corresponding boxes do not need to be completed if it is the intention to make an authorised discharge at sea.

(2) Mund të llogariten.

May be estimated

(3) Moduli i paraqitur duhet të plotësohet i gjithë edhe në rastet e një përjashtimi për anijen

This form is to be completed unless the ship is covered by an exemption.

- Unë i nënshkruari konfirmoj

- *I undersigned confirm*

- Që informacioni i dhënë në këtë njoftim është i saktë dhe i sigurtë

- *that the above details are accurate and correct*

- që në bord ekziston një kapacitet i mjaftueshëm për depozitimin e mbeturinave të gjeneruara nga momenti i njoftimit dhe deri në portin e ardhshëm në të cilin mbeturinat do të dorëzohen.

there is sufficient dedicated on board capacity to store all waste generated between notification and the next port at which waste will be delivered

Data _____

Date

Ora _____

Time

Firma

ANEKSI VI

LLOJET MBETJEVE TË GRUMBULLUARA NGA ANIJET TË CILAT PËRFSHIHEN NË SHËRBIMIN E OFRUAR BRENDË VLERËS SË TARIFËS EKOLOGJIKE TË DETYRUAR NGA TË GJITHA ANIJET DHE MJETET LUNDRUESE

MARPOL – Aneksi 1 OLI – oil	
Ujë sentinash <i>Oil Bilge water</i>	
Mbetje vajore - Slaxhe – <i>Oil residues (Sludge)</i>	
Ujë i ndotur i ballasteve <i>Dirty ballast water</i>	
MARPOL Aneksi II – Materiale helmuese të lëngshme – (m³) /emri <i>Marpol Annex II – Noxious Liquid Substances – (m³) /name</i>	
MARPOL Aneksi IV – Ujë i zbrazur <i>MARPOL Annex IV – Sewage</i>	
Ujë i zbrazur <i>Sewage</i>	
MARPOL Aneksi V – Plehra <i>MARPOL Annex V – Garbage</i>	
Mbeturina ushqimore <i>Food waste</i>	
Plastikë <i>Plastic</i>	
Mbeturina të ngarkesës (pajisje të ambalazhimit dhe mbulimit të ngarkesës etj.) <i>Cargo associated waste (Floating dunnage, lining, packing</i>	

<i>materials, etc)</i>
Prodhime të letrës, lecka, xhama, pece, metalike, shishe etj.)
Mbeturina të djegieve <i>Incinerator ash</i>
Plehra të tjera (specifiko) <i>Others refuse types</i>